



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 233, datë 26.11.2018

PËR

NDALIMIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË AGJENTIT NË SIGURIME
Z. BLENIST ZHUGA

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 199, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në mbështetje të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, neni 19, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, duke marrë shkas nga dy ankesa të ardhura pranë AMF-së me e-mail me datë 24.10.2018 dhe 30.10.2018, ku pretendohet për shitje të policave TPL, jashtë sistemit online të shitjeve dhe nga persona të pa licencuar, kreu një inspektim në vend pranë pikës së shitjes së shoqërisë së sigurimit “Insig” sh.a, që ndodhet në Fushë Prezë, në datë 25.10.2018 dhe 30.10.2018, për verifikimin në vend të rastit në fjalë.

Nga inspektimi është konstatuar se në pikën e shitjes në momentin e inspektimit nuk ishte i pranishëm z. Blenist Zhuga, por zj. Livia Zhuga.

Nga 13 kopje të shitura të policave TPL, 4 polica TPL nuk janë raportuar në kohë reale në Regjistrin e Shitjeve, pasi nuk përputhet kodi i AMF-së me kodin që ndodhet në kopjen fizike të policës, çka do të thotë se fillimisht janë prerë në excel dhe janë hedhur në sistem në një kohë të dytë.

Pra agjenti në sigurime z. Blenist Zhuga ka vepruar, në kundërshtim të nenit 198, pika 4, të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit” dhe në kundërshtim të plotë me kërkesat e pikës 2 të nenit 38, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, si dhe me nenin 5 të Rregullores nr. 23, datë 26.02.2018 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në pikën 5, të nenit 199, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të ndalohet ushtrimi i veprimtarisë së agjentit z. Blenist Zhuga.
2. Ngarkohet Zyra e Licencimit pranë Departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve për çregjistrimin nga regjistri i ndërmjetësve, mbylljen e kodit të shitjes dhe njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI